



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c), të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 11.01.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z.RAGIP FETAHU** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Podujevë, nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Vendenis Lahu.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Ragip Fetahu dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 09.01.2021, Nr.27/2021, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z.Vendenis Lahu, pas dorëheqjes së tij të përvokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye personale.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar, se kandidati i radhës në listën e rirënditur është z. Ragip Fetahu, i cili ka dhënë deklaratën e pranimin të mandatit si kandidat i radhës, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017. Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 11.01.2021

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

